

Idetë dhe parimet e Atë Gjergj Fishtës për organizimin e kombit dhe të shtetit shqiptar

Më 23 tetor të këtij viti mbushen plot 135 vjet nga lindja e Atë Gjergj Fishtës. Fëmija, që e bëri të pavdekshëm në kujtesën historike të shqiptarëve emrin e fshatit ku lindi, pati fatin të pagëzohej me emrin Zef nga poeti e meshtari arbëresh Atë Leonard de Martino. Ky pagëzim prej një poeti, ndoshta, ishte një rastësi profetike e një paralajmërim i atij personaliteti madhor të fëmijës, që do të bëhej një nga personazhet më në zë të letërsisë e historisë shqiptare, para e mbrapa krijimit të Shtetit të pavarur. Personalitet shumë përmasor që arrin maja në poezinë epike, që mbetet i paarritshëm n'atë satiriken, ndër më të spikaturit në lirikë e dramaturgji, me një ndihmesë madhore në publicistikë e në jetën politike e diplomatike, një nga themeluesit e njerzit e mëdhenj të arsimit kombëtar, Atë Gjergj Fishta hyri me të gjithë peshën e tij të stërmadhe në historinë shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX.

Gjithë jeta e tij, fatmirësisht e gjatë për treguesit e kohës, qe një dëshmi e gjallë e forcës së dyshes “Fe e Atdhe” që, për epokën dhe prirjet vetiake të personazhit, ishte Ylli polar që ndriçonte rrugën e Shqipërisë, e cila luhatej mes fundit të një epoke të gjatë pushtimi otoman, që kishte kushtëzuar katër shekuj e gjysmë të jetës së saj të hirtë, e çeljes së një tjetre, e cila kishte një lindje tepër të vështirë, mes pasigurish, cungime trojesh, ndarjeje të kombit, armiqësish të jashtme e mendësish frenuese të mbrendshme. Kësaj epoke historike i dhuroi veprën e tij të gjithanëshme, që nga poezitë e para tek “Albania” e Faik Konicës deri tek kryesimi i Kongresit të Manastirit për alfabetin e shqipes, nga mesha e parë në kishën e Troshanit tek drejtimi i shkollës së Fretërve, nga ngritja e flamurit të Skënderbeut në Shkodrën e administruar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit tek veprimtaria në Komisinë Letrare, e cila vuri bazat e shkencës gjuhësore shqiptare, nga pjesëmarrja në Dërgatën e Qeverisë së Durrësit në Konferencën e paqes në Paris tek veprimtaria e dëndur në Parlamentin e parë shqiptar, nga takimet me Papën Benedikti XV, për të kërkuar ndihmën e tij për Korçën e Gjirokastrën, pjesë të pandashme të Shtetit shqiptar tek vizita në SHBA, për të siguruar njohjen e atij Shteti nga diplomacia e atij Vendi të madh.

Në gjithë ata vite të gjata veprimtarie atdhetare nuk e hoqi kurrë zhgunin e françeskanit e nuk reshti së shkruari në gjinitë e ndryshme letrare, duke i lënë trashëgimisë letrare shqiptare e katolike një nga thesarët më të çmuar të gjithë historisë së tyre. Vepra e tij, e përmbledhur dhe botuar në dhjetë vëllime vetëm në vitin 2012, më shumë se njëqind vjet mbas botimeve të

pjesëve të ndryshme të saj, tregon se sa mosmirënjohëse dhe e padrejtë, deri në kriminalitet, qe Shqipëria e “dreqit të kuq” kundrejt krenarisë së kombit. Tre breza shqiptarësh nuk i njohën as emrin atij që bota e huaj e kishte vlerësuar si “Homeri i Ballkanit” e që e kishte nderuar me çmime e medalje, që nga Turqia deri tek Austro – Hungaria, Vatikani e Greqia. I pari poet shqiptar, i pranuar si antar i Bashkimit Ndërkombëtar të Poetëve, një Shoqatë botërore e themeluar në New York, me përfaqësues nga 60 vende, e mbylli jetën e tij, si i vetmi antar shqiptar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Italisë.

Asnjë nga këto merita të shquara të Gjenuit të Kombit nuk e penguan regjimin kundër kombëtar të komunistëve shqiptarë, të hidhte në lumin Drin eshtrat e tij e të varroste në harresën e shoqërisë emrin e tij të ndritur, duke e mbiquajtur “shovinist”, “fashist”, “obskurantist”, simbas oreksit të komunistëve jugosllavë.

*“Dersa t’mundem me ligjërue
E sa gjallë me frymë un jam,
Kurrë, Shqypnî, s’kam me t’harrue
Edhe n’vorr me t’përmendë kam.”¹*

Kjo ishte besojma e Atë Gjergj Fishtës, së cilës i qëndroi besnik gjatë gjithë rrugës jo të lehtë të jetës së tij. Shqipërisë, Poeti i saj kombëtar, i shërbeu me të gjitha dhuntitë e rralla të natyrës së tij, me shpirtin rebel e mëndjen e hollë, me talentin rrezatues e logjikën e ftohtë, me burrërinë e malsorit dhe urtësinë e birit të Shën Françeskut. Por cili ishte mendimi i fratit e i poetit, i politikanit dhe i dijetarit, i oratorit dhe mësuesit për Vendin e tij, si e shihte ai gjëndjen e atëherëshme dhe t’ardhmen e tij? Ishte ky argumenti i shumë shkrimeve, që zuri vendin kryesor në jetën e tij të gjatë publicistike. Në këtë këndvështrim Fishta pasoi dhe parapriu shmë përfaqësues të inteligjencës e të kulturës, të cilët, për nevoja të ngutëshme të jetës politike, i dhuruan kësaj të fundit një pjesë të mirë të kohës, të vullnetit e t’aftësive të tyre. Zhvillimet historike të kombit tonë, me të veçantën e tyre, i ngarkuan mbi shpinë njerëzve të kulturës, të fesë apo t’artit, barrën e ringjalljes, jo vetëm kulturore, por edhe politike të kombit. Prandaj pjesa më e madhe e shkrimtarëve shqiptarë u kthyen edhe në veprimtarë politikë. Atë Gjergj Fishta ishte njëri ndër më të shquarit e asaj plejade atdhetarësh, që i solli freskinë e kulturës perëndimore evropiane jetës politike shqiptare.

*“Prandej detyrët qi nieri ka per t’vu mi shekull janë kto : **Feja, Atdheu, Gjindja e Dija**. Feja, pra, e dashnia e Atdheut e e Gjindies e Dija janë njato vegla qi e bânjë nierin t’lum n’ket jetë edhë n’jetë t’amshueme ; pse neper kto*

1 GJ. FISHTA, *Mrizi i Zanave*, në *Vepra*, vëll. I, Enti botues “Gjergj Fishta”, Lezhë 2012, f. 18.

*niery kryen detyrët, prej t'cillave rrjedhë t'gjith lumnia e tij..."*²

Në numrin e parë të *Hyllit të Dritës*, një nga monumentet më të arrira të publicistikës shqiptare të gjysmës së parë të shekullit të pavarësisë e të robërisë, Atë Gjergj Fishta përcaktoi vlerat madhore, që janë shtyllat, mbi të cilat mbështeten ngrehinat e kombeve, historia e tyre dhe vendi që do të zenë në ecjen e përbashkët të qytetërimit. Nuk është e rastit që, në këtë shkallëzim vlerash, feja është në rradhën e parë. Në të gjithë krijimtarinë e tij publicistike ai do të kthehej herë pas here mbi atë argument, madje edhe nëpërmjet polemikash të fuqishme. Ai ishte një katolik i vendosur, që ushqente idenë se besimi në Krishtin shpëtimtar dhe doktrinën e tij, ishte një nga mjetet më të fuqishme, që ndihmonte moralizimin e jetës së një populli. Urdhërimi kryesor i Jezuit: *"Duaje Zotin mbi gjithshka, duaje t'afërmin si vetveten"*, është themeli më i qëndrueshëm për harmoninë e dashamirësinë mes antarëve të një bashkësie e për paqen e bashkëjetesën ndërmjet popujve të ndryshëm. Kuptohet se pse regjimi komunist dhe kultura e tij e nxinë, përtej çdo përfytyrimi, emrin dhe veprën e françeskanit të madh, mbasi ata kishin në bazë të ideologjisë së tyre vepruese urrejtjen dhe "luftën e klasave", të cilat nuk njihnin kufij, as në kohë dhe as në hapësirë.

Por feja, në gjithë pozitivitetin e saj në jetën e çdo populli, nuk mund të shkëputet nga koncepti i bashkësisë së njerëzve në të cilët ajo predikohet dhe zbatohet. Atdheu, toka e njerëzve që i bashkon gjuha, doket, zakonet, historia, është trualli mbi të cilin ngrihet jeta e përbashkët, një lloj shtëpie e stërmadhe, në të cilën secili do të gjejë strehën e tij. Nëse feja, kryesisht, është pjesë e jetës shpirtërore, më shumë e prirur të pushtojë sferën vetiake, Atdheu, si shtëpia e përbashkët, mbetet në qendër të vëmëndjes dhe interesit të përgjithshëm, në të cilin lindin e rriten projektet, ëndërrat e synimet. Atdheu është gjindja, njerëzit që flasin të njëjtën gjuhë, është ajo bashkësi e madhe, që i ngjet detit në të cilën derdhen të gjithë lumenjtë që i ngjasin bashkësive të vogla, krahinavet, qyteteve, fshatrave, lagjeve e deri tek indet e para të shoqërisë, familjet. Tre konceptet lidhen organikisht me njëri tjetrin, për të përqafuar më pas të katërtin, që është Dija, e cila shërben si një lidhëse e fuqishme, pa të cilën ndërtesa e kombit është e paracaktuar të mbetet e mangët dhe rrezikon të shëmbet.

Një komb, për t'u futur në rrugën e përparimit, ka nevojë të besojë tek Zoti për barazpeshat e tij morale e shpirtërore, të ketë si synim lartësimin e idesë s'Atdheut e zhvillimin e tij, i cili duhet të shkojë me të njëjtin hap me mirëqënien e gjindies, të qytetarëve t'organizuar në familje e bashkësi më të mëdha, në harmoni e bashkëpunim me njëra tjetrën e të verë në bazë të punës së tij mëndjen, në të gjitha shfaqjet e saj të larmishme e të pafund, dijen e grumbulluar nga përvoja e brezave dhe e popujve të ndryshëm,

2 GJ. FISHTA, *Përndritje. Analiza, polemika, kronika*, Lajmëtari, Tiranë 2000, f. 11.

kulturën që mbetet pasuria m'e madhe e trashëgimisë njerëzore.

Fishta filloi të botojë *Hyllin e Dritës* në vitin 1913, fill mbas shpalljes së Pavarësisë e krijimit të Shtetit shqiptar. Problemet me të cilët ballafaqohej Shqipëria foshnje ishin të shumta e të ndryshme. Armiqësia që rrethonte atë prej fqinjëve dhe përkrahësve të tyre dhe fakti që, për herë të parë, në historinë e saj mijëvjeçare, krijohet një Shtet i bashkuar, i jepnin shkas përhapjes së një fryme mosbesimi n'aftësitë vetqeverisëse të shqiptarëve. E formuluar si një teori keqdashëse në librin "Shqiptarët e Fuqitë e Mëdha", i botuar në dy gjuhë kryesore evropiane, frëngjisht dhe gjermanisht, nga një serb me origjinë shqiptare Dr. Vlladan Gjorgjeviç, ish Kryeministër i Serbisë, teza mbi paaftësinë shtetformuese të shqiptarëve, qarkullonte jo vetëm në rrethet politiko – diplomatike, por edhe në shtypin evropian. Si edhe të tjerë bashkatdhetarë të dijshtëm, drejtori i "Hyllit të Dritës" mori përsipër kundërshtimin e kësaj teze. E kreu nëpërmjet një artikulli të gjatë me titullin "A janë të zott shqyptarët me u mbajtë shtet m'vedi?" Me logjikën e fortë e kulturën e thellë, pa lënë mënjanë edhe shpotinë karakteristike, ai polemizon me fletoret franceze që "i a kanë dhânë alemit e polemit, se shqyptarët nuk janë t'zott me u ndertue e me u mbajtë shtet m'vedi, porse u duhen lshue sllavve t'Ballkanit n'dorë per me i zbutë e me i gjytetnue."³

Argumenti kryesor i mendimit të Fishtës është ndërtesa morale e shqiptarëve si popull. Është e vërtetë që "populli shqyptar nuk çfaqet n'histori si një kòm i organizuem e i pershîmun marë permrëna çarkut t'nji njinis komtare..."⁴, por arsyet janë jo "barbaria", që i veshin keqdashësit dhe kundërshtarët, por një seri motivesh historike, politike e topografike, të cilat kanë përcaktuar rrjedhën e ngjarjeve në Ballkan. Ai nuk i kurseu kritikën, edhe shumë të forta kundrejt bashkatdhetarëve të tij, por në një përplasje argumentash e rrahje mendimesh me gazetën franceze, nuk vihet t'i nxjerrë në pah ato, por të kundërshtojë prirjen për ligjësimin e akuzave të përfolura në mjediset kundër shqiptarëve në drejtim të poshtërimit të tyre. Përbërja shpirtërore e shqiptarëve, ligjet e botës së tyre morale mbështeten mbi "trinomin tagruer : mos me i bâ dhûnë kujë, me i dhânë sejcillit shka i perket e me veprue gjithmonë me nder."⁵ Ky është qytetërimi i vërtetë, që nuk shfaqet në vepra të mëdha arti apo shkence, por që pasqyron thelbin e moralit e të bashkëjetesës njerëzore, atë "humanitas" të cilin e kanë predikuar njerëzit e shquar, që nga profetët e deri tek gjenitë e fushave të ndryshme. Ka edhe ndërmjet shqiptarëve barbarë e kriminelë, siç ka në të gjithë popujt, por e përgjithëshmja është pozitive. Ndërmjet të tjerash Fishta vë theksin mbi frymën demokratike të Kanunit e të ligjeve shekullore të shqiptarëve, duke i përballur ata me shtetet e mëdha e perandoritë e

3 Po aty, f. 15.

4 Po aty, f. 16.

5 Po aty, f. 17.

tyre, ku mbretërit kishin fuqi të pakufizuar.

Një tjetër provë, në mbrojtje të bashkatdhetarëve të tij, kryepoeti e gjen në artin e tyre, në poezinë popullore, aq shumë të vlerësuar nga filologu austriak Prof. Gustav Mayer që i shkruan Prof. Zef Schiro-it se *“kurr nuk i ka tokue me lexue nji Poezi Popullore mâ t’hijshme se ate t’shqyptarve.”*⁶ *“Prandej dy janë objektet mâ t’para e mâ t’perhapuna t’Poezis Popullore : trimnia e dashnija. Mnyra, pra, mas t’cilles kuptohet e çfaqet nder kangë burrnija, trimnija e dashnija, na dishmon zhdrivillimin e mëndes e ndfësit e zëmres s’nji popullit...”*⁷ Poezia popullore, si pasqyrë e botës së mbrendëshme shpirtërore të një populli, paraqet të gjitha prirjet e tij, të shfaqura ndër shekuj, jo vetëm në drejtim të shijeve estetike por, mbi të gjitha, të botëkuptimit, të filozofisë së tij jetësore, të parimevet që drejtojnë shoqërinë. Në rastin e shqiptarëve, Poezia popullore pasqyron një popull paqësor e të ndieshëm, në të cilin zotërojnë kultet e dashurisë dhe të trimërisë, të konceptuar si vlera themelore në jetën e individit, por edhe të shoqërisë. Autori gjen në trajtimin e tyre të njëjtat përceptime të popujve të qytetëruar. Trimëria nuk është shfaqje e mujshisë apo dëshmi e fuqisë fizike që shkon në dëm të të tjerëve më të dobët, por mjeti për të mbrojtur veten dhe t’afërmit nga rreziqet e jashtëme, në të cilët gjithmonë shqiptari ka parë kërcënimin e tij. Heronjtë e poezisë epike shqiptare luftojnë me bajlozët që kërcënojnë jetën e tyre, të familjeve apo të katundeve të tyre gjithmonë në trojet e tyre, asnjëherë nuk mësyjnë për të skllavëruar popuj të tjerë. Kjo është e vërteta historike e pamohueshme, që mund t’interpretohet nga kundërshtarët dashakeqë si pazotësi, por që vërteton një prirje morale të lëvdueshme, në përputhje me respektin e vlerave njerëzore e të pohimit të tyre. Poeti merr si shembull balladën “Halili e Hajrija”, ku ndërthuren ndjenjat me detyrën, ndëshkimet me dhimbjen, ku triumfon drejtësia dhe e mira, me gjithë çmimet e tyre. Do të mjaftonte vetëm thesari i folklorit, për të shpalosur botën shqiptare e për të rrëzuar, nëpërmjet vlerave të saj, çdo padi apo insinuatë të padrejtë kundrejt një kombi të shqiptarëve, aq më shumë kur ato vijnë nga një tribunë aspak e hijshme si ajo sllave, e ngarkuar me gjakun e pafajshëm të mijëra shqiptarëve të Kosovës.

Shqipëria në shpërgënj nuk duhej të ballafaqohej vetëm me opinionet e shtrembëra të shtypit evropian, me të cilët përleshej Fishta, por edhe me vetë politikën shtetërore të vendeve të ndryshme t’Evropës, jo dashamirëse kundrejt saj. Në shkoqitje të këtyre politikave, në vitin e mbrapshtë 1914, politologu françeskan nuk respekton aspak gjuhën diplomatike. Me krenarinë e malsorit të vetëdijshëm për epërsinë e tij morale, si njeri fjalës së mbajtur e i respektimit të vlerave njerëzore, ai vërsulet mbi politikën e diplomacive evropiane me të gjithë forcën e penës së tij të hidhur. Gjatë

6 Po aty, f. 23.

7 Po aty, f. 29.

gjithë veprimtarisë së tij, nuk ka qenë asnjëherë i butë me “kurvën e motit”, kur ajo tregojë e padrejtë ndaj Vendit të tij e, fatkeqësisht, shekulli i shkuar nuk qe aspak i kursyer me padrejtësi kundrejt shqiptarëve.

“Kështu pra, pa nderë e pa kurrfarë burrniet Europa u prû ndaj Shqypnis shî n’kohë, kur kjo kishte mâ nevojë me kë në prej saj. E pra mretnien e Shqypnis Europa e kishte krijue! Por shka se pabesnia e pushteteve t’Mdhâ duel edhe mâ n’shesh n’t’caktuem t’kufijvet t’Shqypnis.”⁸

Për meshtarin atdhetar është e papërligjësme që Evropa të qëndrojë vrojtuese e thjeshtë e faktit që ushtritë sërbe, greke e malazeze, si ujqit e tërbuar të zaptojnë tokat shqiptare, për të cilat ajo vetë kishte vendosur në Londër se duhet të bënin pjesë në një shtet të pavarur.

“Me ç’sÿ e faqe Europa ka me pritë gjygjin e historis, qi sodmesod, n’sÿ t’mkâmsve t’saj, po mund t’pertrihen n’Shqypni pûnë t’dhûnshme pa pasë nieri se kû me kja, se ku me lypë gjygj ? N’dy vjet qi Evropa ka marrë n’dorë pûnën e Shqypnis, jo veç se ndër ne nuk ka hî gjykatore t’ligjshme e t’njimëndët, por s’ka një statut, s’ka një themel ligjet, s’ka një sundimtar t’vetëm qi t’ket dependencë t’vertetë prej Mretit e një fuqi t’ligjshme n’dorë. Gjaku i shqyptarit derdhet rrakajë, gjâja e shqyptarit hupë nder thoj t’mâ t’fortit...”⁹

Tablloja e përshkruar është vërtetë tronditëse, një realitet i hidhur por, ndoshta do të kishte vënd edhe për një farë autokritike në planin e përgjithshëm, mbasi vitet 1913 – 14 nxorën në dritë, krahas padrejtësive të Fuqive të Mëdha edhe krijimin e rrymave e të dasive në gjirin e klasës drejtuese shqiptare. Rrëzimi i Ismail Qemalit dhe kalimi n’anën e Esat Pashës i mjaft prej intelektualëve shqiptarë nuk dëshmojnë për një qëndrim t’urtë e bashkësi mendimesh e qëllimesh në drejtimin e shtetit shqiptar në një çast vendimtar. Megjithatë protesta e Fishtës dhe padia e tij, jo vetëm qëndrojnë në planin historik, sa që ende sot, mbas më shumë se një shekulli, mjaft prej problemeve tona e kanë zanafillën pikërisht n’ato vendime e qëndrime, por dëshmojnë edhe ndjenjën e lartë të atdhedasurisë së shkrimtarit, për të cilin fati i Vendit është në majën e shqetësimit të shpirtit të tij vullkanik.

Ai fat nuk është vetëm në duart e të huajve. Për këtë ishte i ndërgjegjësëm frati françeskan dhe ai ishte derti më i madh që bartëte në bisedat, në shkrimet, në takimet me bashkatdhetarë e me të huaj. Keqardhja për mangësitë e shqiptarëve, për nivelin e tyre t’ulët kulturor, për mungesën e konceptit t’idealeve dhe interesave të përbashkëta, për pamjaftueshmërinë e gjykimit dhe përceptimit të së vërtetës së marrëdhënieve mes tyre, janë shqetësime të përherëshme, që ngrenë krye vazhdimisht në shkrimet publicistike.

“Mjaft me ja lshue sÿt pa pajë e me gjak t’ftoftë, si i thonë, vepers qi na kemi zhdrivillue n’kto tetë vjetë, pse menjherë kemi me u vertetue se na jemi

8 Po aty, f. 45.

9 Po aty, f. 47.

prû, jo ndryshe veç si fmî e si e zeza e vedvedit qi kemi kênë gjithmonë. Po e xâm : mretin tonë nuk e ka xjerrë prej Shqypniet as inglizi as Franca as Rusia vetun, por e kan nxierrë shqyptarët!”¹⁰

Fishta historian shqyrtton një nga çastet më të rëndësishme e vendimtare të historisë sonë, periudhën e shkurtër të mbretërimit të Princ Wied-it, e anashkaluar sipërfaqësisht nga historia zyrtare e regjimit komunist, e cila “zbuloi” me entuziazëm në rebelimin anadollak të Musa Qazimit e Haxhi Qamilit, bërthamën e parë të “revolucionit” komunist në Shqipëri, një ngjarje për t’u vënë në kornizë e për t’u nderuar si një shembull i lartë i “urtësisë” popullore. Si pasojë e asaj ngjarjeje tragjike për kombin, po aq vendimtare në kah negativ, sa edhe Shpallja e Pavarësisë në atë pozitiv, Shteti i ri shqiptar humbi rastin që i ishte dhënë, të ruante lidhjen me Evropën, nëpërmjet Princit të caktuar për t’u bërë Mbret në territorin e tij, simbas kërkesës së pjesës më të madhe të atdhetarëve shqiptarë. Ajo lidhje do të kishte qënë tepër e rëndësishme për rrugën që do të ndiqte Shteti i ri, duke fituar besimin dhe qëndrueshmërinë edhe në sytë e atyre Pushteteve të Mëdha që e kishin cunguar në krijimin e tij. Hapat e parë në drejtim t’organizimit të jetës shtetërore, megjithë vështirësitë e mëdha, u panë edhe n’ata pak muaj të qeverisjes së Princit. Por për një fatalitet të zi historik tonin n’atë periudhë të brishtë, do të fuqizohej e do të zotëronte një lëvizje që destabilizoi plotësisht atë përvojë pozitive, që ishte fituar në më pak se dy vjet pavarësie. Pasojat qenë shkatërruese, me vite të gjata pushtimi të gjithë territorit nga ushtritë ndërluftuese, me marrëveshje të fqinjëve për coptimin e tokave shqiptare, me rrezikimin për t’u zhdukur si shtet në Konferencën e Paqes. Autori i shkrimit, me largpamësinë dhe mprehtësinë e gjykimit, e vajton në vetvete atë çast të mbrapshtë historik, nuk nguron t’a shohë të vërtetën në sy e të nxjerrë përgjegjësitë që rrjedhin nga paformimi i ndërgjegjes kombëtare, si pasojë e prapambetjes së theksuar ekonomike, që i bën bashkatdhetarët e tij të jetojnë të ndarë në bashkësi të vogla, pa asnjë lidhje me njëra tjetrën. Prandaj ai përsëndet me entuziazëm nismat austro – hungareze për shtrimin e rrugëve dhe hapjen e shkollave. *“Udhët e mara e shkollat e mira janë agimi i parë i gjytetnës. E ta diejn shqyptarët, qi dersa t’ngurrojn me pûnue rrugat e me la per shkolla, s’kan me kênë kurr popull i dëjë me pasë vetvetsi morale n’shekull ; pse edhë ne ja u dhaçin tjerët, kan me e shpartallue kta vetë, sikursë edhë i kemi shpartallue.”¹¹*

Është një diagnozë e saktë e patologjisë së çastit historik, që mbart në vetvete shpresën dhe hidhërimin deri në dëshpërim e mosbesim. Shkrimtari mundohet t’u hapë sytë bashkatdhetarëve, t’u verë piketat e arsyes në rrugën e tyre të ecjes drejt qytetërimit evropian, të cilin ai e quan si të vetmin model për t’u huajtur edhe prej tyre.

10 Po aty, f. 50.

11 Po aty, f. 52.

“Lypset qi t’gjith t’shestuemt e t’rregulluemt e jetës s’shoqnueshme n’Shqypni t’jet themelue mî parsime t’gjytetnis prendimore, por me shart qi, der kû ta bajë natyra e ktyne parsimeve, kta t’qiten n’punë mas gjenjes e etnologjis s’vendit e mas ndîsive t’popullit n’mnyrë qi t’ruhet paqja e zëmrave edhë karakteri komtar i shqyptarve.”¹²

Publicisti, meshtari e poeti i lëshojnë Vendin urtësisë së shtetarit dhe largpamësisë të njohësit të thellë të grigjës së vet, që din t’a drejtojnë në rrugën më të sigurtë e më me pak rreziqe. Evolucionit i shqiptarëve drejt mendësisë evropiane nuk mund të jetë një “deus ex machina” e përnjëherëshme, një kopjim i plotë e i vrullshëm i përvojave perëndimore e i futjes shabllone të tyre në jetën shqiptare. Në këtë rast do të kishim një çoroditje të plotë që në vend të përparimit do të sillte anarkinë e veprimeve dhe amullinë e mendimeve. Harmonizimi i parimeve të qytetërimit perëndimor me psikologjinë, traditat e formimin shpirtëror të shqiptarëve në masën dhe kohën e duhur, janë siguria që sheh autori që *“komi shqyptar t’jet përnjimend kom e kom i qytetnuem”* Por nuk mjafton që procesi zhvillues mendësor i shqiptarëve të vihet në baza t’arësyeshme, që të prodhojë vetëdijesimin për domosdoshmërinë e thithjes dhe përnjisimit të përvojave të tjerëve, nëse nuk bëhet përzgjedhje e klasës drejtuese nëse ajo nuk do të ketë shtatin moral e profesional të duhur.

“Me e lshue Shqypnën nder duer t’batakçive, âsht njapernja si me ja vjerrë ujkut mushknit m’qafë, me uzdajë se po t’i çon te shpija : ujku i han mushknit, sidomos per n’kjoftë msue ndojherë me hangër m’tô.”¹³

Sa profetike këto fjalë të shkruara pothuajse njëqind vite më parë. Sa shumë i vërtetoi koha ato, sidomos që prej 70 vjetësh e këndeje, madje edhe në vitet e demokracisë e të ngarendjes drejt Evropës, sa dëme i sollën Shqipërisë *batakçinjtë* në drejtimin e saj, sa shumë e varfëruan për t’u pasuruar ata. Çështja e moralitetit të klasës drejtuese është një temë që e rrok disa herë në artikujt e tij, duke vënë në lojë politikanët e improvizuar e demagogë, që nuk janë t’aftë të bëjnë asgjë tjetër, veçse t’i kushtohen “politikës” së thirrjeve pa përmbajtje, të reformave të rreme e formale, të mashtrimeve me qëllim që të fitojnë votat, për të pasur një pozitë që do t’u japë mundësi të përvehtësojnë sa më shumë. Që nga koha e Fishtës e deri në ditët tona kanë kaluar dhjetëvjeçarë të tërë, por kjo sëmundje e shqiptarëve duket se ende nuk ka gjetur shërim edhe se më 1921 shkrimtari i madh i drejtohej kështu bashkatdhetarëve të tij: *“A vagabondët jashtë pune e jashtë Shqipnis, ose ndryshe kemi sharrue me të egër e me të butë.”* Fatkeqësisht shqiptarët nuk qenë t’aftë a nuk deshën t’a zbatojnë atë porosi, madje i vunë ata në krye të tyre e sharrimi qe më i plotë e më i rrezikshëm edhe se sa e përfytyronte poeti kombëtar.

12 Po aty, f. 58.

13 Po aty, f. 59.

Një tjetër problem, ndoshta më i mprehti i rrugës historike të shqiptarëve në shekuj, mbetet edhe në fillimet e Shtetit të pavarur, prirja e tyre endemike për të mos bashkëpunuar me njëri tjetrin. Shqipëria e qytetshteteve të lashta apo e shteteve të ndryshme ilire në luftë me njëri tjetrin, e ndarjeve administrative romake e bizantine, e principatave shqiptare para-turke, e vilajeteve pa lidhje me njëri tjetrin, ishte një realitet historik, tashmë i kapërcyer. Në Kongresin e Berlinit pjesa më e ndritur e prijësve shqiptarë kishte ngritur çështjen e kombit, në kuadrin e perandorisë turke dhe ishte kundërvënë ndaj vendimeve të tij për dorëzimin e trojeve shqiptare, pikërisht duke patur si motiv qenësor e shtytës konceptin e tërësisë tokësore të trojeve ku flitej gjuha shqipe. Luftërat ballkanike, pavarësia dhe vendimet e konferencës s'Ambasadorëve në Londër, e ngritën në rendin e parë, si jetik, të domosdoshëm e të pashmangshëm problemin e bashkimit kombëtar. Në një sërë artikujsh Fishta e trajton me përparësi këtë domosdoshmëri të jetës shqiptare. *“Prandej lypset domosdo qi t'i zhdrivillojmë pak mâ gjatë mendimet tona permî bashkim t'komit shqyptâr, pse, pa bashkim , s'ka me pasë mas sodit as Shqypni, as shqyptarë, e t'gjith na kemi me pasë vendin n'ujë t'pafund.”* shkruante ai tek “Posta e Shqypnis” më 30 janar 1917, kur Shqipëria ishte e pushtuar nga ushtritë ndërluftuese. Por lufta do të mbaronte e shteti shqiptar, i njohur më 1913 në Londër, do të rifillonte ecjen e tij. Prandaj duhej pregatitur shpirtërisht e ardhmja. Autori shtjellon kriteret dhe bazat, mbi të cila duhej mbështetur procesi i bashkimit, që ishte faktori i parë i domosdoshëm në mbarëvajtjen e Shtetit. Është interesante ideja e shkrimtarit për zgjedhjen e modelit për t'u marrë si shembull, jo si sistem shtetëror apo shoqëror, por si sistem të menduari e të konceptuari të jetës e të shoqërisë.

*“Prandej, t'gjith njatà qi e kan me detyrë , si edhe atà qi ja kan vû vedit me detyrë me organizue jeten shoqnore e t'gjytetnueme n'Shqypni..... mâ s'parit t'caktojnë se mas cilles kulturë duen me e organizue komin shqyptâr, e masandej me ligjë, me pûnë e me kohë të mundohen me i bâ shqyptarët qi t'mendojnë e t'veprojnë mas parimesh t'asaj kulture , tuj majtë parasysh etnologjin, psikologjin, e ndâsit besimtare t'tyne..... Bashkimi i komeve e t'ndertuem e shteteve nuk ngrehet mí flaurí t'ajrit, por mí parime t'verteta t'filozofis e t'historys. Kushdo mendon e pûnon ndryshe per Shqypni, ai rrên vedin e shqyptarët...”*¹⁴

Kjo pikpamje ishte bijë e kohës në të cilën gjithshka duhej filluar nga e para e kërkohej një mbështetje, jo vetëm shtetërore dhe ekonomike por edhe kulturore, në të cilën shqiptarët të shihnin perspektivën e tyre të s'ardhmes. Fishta anonte nga simpatia për kulturën austriake e cila, nëpërmjet politikës, kishtë qënë njëra nga mbështetëset kryesore të Shpalljes së Pavarësisë e nëpërmjet institucioneve të saj ndihmonte në

14 Po aty, ff. 70-71.

arsimimin e shqiptarëve. Por kjo ide nuk ishte e pranuar nga të gjithë, mbasi ndikimet në mendësinë shqiptare ishin të ndryshme. Pavarësisht nga dobia apo jo e opsionit që propozon shkrimtari, shqetësimi i tij për idenë e bashkimit, jo vetëm territorial, por edhe kulturor e shpirtëror të shqiptarëve, në kushtet e dasive fetare e krahinore të theksuara, ishte më se i përligjur dhe dëshmonte jo vetëm dashurinë e tij për Atdheun, por edhe idenë e qartë e të drejtë që ai kishte për të.

Në këtë kontekst të formimit të kombit të bashkuar hyjnë edhe trajtimi i temave tepër të rëndësishme, si gjuha dhe arsimi shqip. Simbas poetit, janë këto themelet mbi të cilët do të ngrihet godina e Shqipërisë së qytetëruar. Ashtu sikurse në të shkuarën osmane, mungesa e arsimit në gjuhën shqipe qe njëri ndër faktorët më qenësorë të vonësës në vetëdijësimin e shqiptarëve për çështjen e tyre kombëtare, sot ai do të jetë një nga shtytësit më të fuqishëm të sendërtimit mendësor të kombit të bashkuar. *“Parja mâ e çmueshme per Shqypni asht zëmra shqyptare : e zëmra perbâhet nder shkolla neper msim t’gjuhës shqype.”*¹⁵ Meshtari e mësuesi atdhetar, që drejtonte vetë shkollën e fretërvet, me rezultatet më të mira, në shkrimet e tij i kërkon bashkatdhetarëve të dërgojnë fëmijët nëpër shkolla, madje të ndihmojnë edhe me para shkollat, në mënyrë që në to të mund të studiojnë edhe fëmijët e familjeve të vobekta, të cilat nuk kanë mundësi të paguajnë për shkollimin e bijve. *“Prej nji t’rritunit t’mirë t’fmive rrjedhë gjytetnia e përparimi i komit: kushdo shqyptâr, pra, qi pernjimend don komin e vet, s’do të kursehet me u nîmue shkollave. Kohë t’vshtira janë, por detyra e komit per t’rritun t’fmive âsht mâ e rândë.”*¹⁶

Ndihmesa e tij n’arsimin kombëtar, nëpërmjet institucioneve shkollore të françeskanëve, ishte e dorës së parë. Ai do të mbronte deri në fund vlerën dhe dobinë e atyre shkollave n’edukimin e shqiptarëve, madje duke u përplasur ashpërsisht në debat me të gjithë ata intelektualë “përparimtarë” që mundoheshin të mënjanonin klerin katolik nga arsimi shqiptar e që, nëpërmjet një dekreti famëkeq të Ministrit mason Mirash Ivanaj, arritën t’i mbyllin ato shkolla, nxënësit e të cilave ishin krenaria e inteligjencës shqiptare, si përsa i përkiste përgatitjes teorike, ashtu edhe qëndrimin atdhetar e moral.

Janë shkollat e kultura që do të ndryshojnë jetën e shqiptarëve që, fatkeqësisht, ka mbetur më larg qytetërimit se sa popujt e tjerë. Por ndërsa deri tani i ka mjaftuar *“nji kafshatë bukë, nji zhel m’shtat, dy tjegulla mbi krye, do grazhd per shtrojë e nji armë”*, siç shprehej poeti, tani e tutje ai do të ketë të tjera kërkesa *“m’t’perpjekun me kulturë prendimore t’Europës, si domosdo do të gjindet mas sodit Shqypnija.”*¹⁷ Autori ishte i ndërgjegjshëm

15 Po aty, f. 83.

16 Po aty, f. 84.

17 Po aty, f. 86.

për punën e stërmadhe që duhej për të dalë nga kjo e keqe. Rruga e vetme, simbas tij, ishte mobilizimi i skajshëm i fuqive të mbrendëshme shpirtërore e mendore që nuk i mungonin racës, por duheshin nxitur e vënë në punë. Detyra e parë ishte ndërgjegjësimi i shqiptarëve për t'ardhmen e tyre. Ai duhej t'ishte misioni i parë i një prijësi dhe Atë Gjergj Fishta ishte me të vërtetë një prijës, jo në karrigen e ngrohtë të një zyre shtetërore, por në jetën shpirtërore të popullit të vet. Ishte një prijës largpamës e i ndershëm, që njihte mirë historinë e botës dhe kulturat e saj, që dinte të zgjidhte e të përfntonte prej tyre atë që i nevojitej e i vlente bashkatdhetarëve, një prijës malesh ku fjala nuk kishte kurrë dy kuptime, por ishte e qartë dhe e singertë. Ballafaqimi me Evropën do të nxirrte në dukje më me forcë mangësitë tona, jeta do të ishte gjithënjë e më tepër një garë, ku do të fitonte ai që ishte më i përgatitur e më i zoti. Në pabarazi aftësish, humbet më i paafiti që rrezikon të përfundojë si shërbëtor, të humbë atë pavarësi që e ka ruajtur në një sistem të mbyllur e të prapambetur, por i cili është i paracaktuar të mbarojë në mënyrën e re të jetesës. Nëse nuk i dilet para këtij rreziku, nëse nuk shpërvilen mëngët seriozisht për të punuar në skaj të fuqive tona, rrezikohet gjithshka, edhe liria e fituar.

*“Pa shkollë, sod e mbrapa, s’ka Shqypni as ka shqiptarë ; e na kemi me hupë t’fikun e t’koritun. E shkolla, qi do t’ndjekë shqiptari, do t’jet taman shkollë, e jo shkollë me êmen e sa me i lshue vedit plûhen sýsh ; pra, shkollë kû nieri pernjimënd zên me krye detyrët qi ka ndaj Zotit, ndaj shoqit e ndaj vehtes : shkollë besimtare, atdhetare e sistematike. N’shkollë masandej do t’shkojnë gjytetas e katundarë, t’pasun e t’papasun, t’kshtênë e mysliman, per n’mos daçin me sharrue perjetë nën peshë t’kapitalit t’huej e mos me u njuhë mâ shqyptarë.”*¹⁸ Kështu shkruante më 13 tetor 1917 n’artikullin “Shqypnia e kultura”. Mesazh më largpamës e më të singertë, më bindës e më atdhetar, është e vështirë t’a gjejmë në historinë e kulturës sonë.

Atë Gjergj Fishta, veç detyrëve të veta kishtarë, arsimore e kulturore, ka qenë edhe deputet në parlamentin shqiptar, mbasi kishte qenë edhe Sekretar i Dërgatës shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris, kur Kryetari ishte Imzot Luigj Bumçi. Mbi veprimtarinë parlamentare, veç bisedave në mbledhjet e seancave, ka edhe mjaft artikuj, në të cilët shpalosen pikëpamjet e tij mbi jetën politike. N’artikullin “Lirija e zgjedhjeve e obstrukcioni i Opozitës”, në “Hylli i Dritës” n° 10, 1923, gjejmë mjaft mendime të deputetit të Shkodrës mbi jetën parlamentare. Hasim në dukuri që ngjasojnë me punimet e Kuvendit të ditëve tona, debatet e ashpra Shumicë – Opozitë, fyerjet, daljet nga salla, obstrukcionizëm, korrupsion, blerje votash etj. Por është me interes të shqyrtohet sistemi i votimit me zgjedhës të dytë që, në një Vend me 95 % analfabetë, ishte quajtur më i miri për të zgjedhur deputetët. Autori ishte i mendimit të Opozitës, që kërkonte

18 Po aty, f. 88.

më shumë zgjedhës të dytë, sepse kështu do të kishte më pak mundësi blerjeje të tyre. N'ata vite të para të jetës parlamentare, për vetë stadin e zhvillimit të shoqërisë, janë të kuptueshme këto dukuri. Gjykimi i Fishtës mbi kolegjet e parlamentit e të qeverive nuk është aspak vlerësues.

“Për me sundue një shtet, nuk është mjaft dhelpnija, dredhija, intriga, bataqçillëku, rrëna, tradhtija : duhet nderë, dije, urti, burrní, qe se shka duhet. Po, por dija, urtija, ndera, burrnija, po u zëjshin në shkollë e, madje me shumë mund e djersë, e jo nder kafëshantanta t'Europës, e mejhane e paçaxhihane të Tiranës, tuj lujtë “tavull” e “bixhoz” e tuj pi “mastikë. Shifet kjartas prà, qi e shumta e nierzve të shtetit shqyptar jo veç se nuk duen, por as nuk janë të zott, me ja sjellë të marën e të mirën shtetit e komit, e sa prandej kta janë atà mikrob, qi janë tuj pi gjakun e tuj ja shkurtue jetën Shqyptnis s'mjerë.”¹⁹

Kështu shprehej Atë Gjergji në pranverën e vitit 1924 në shkrimin “Delikti i Mamurrasit e gjëja e lingatueme e shtetit shqyptar”. Janë gjykime të rrepta, që burojnë nga konceptet puriste t'autorit mbi politikën, apo është një fotografi e politikës shqiptare t'asaj periudhe ? Ndoshta e vërteta qëndron në mes të këtyre dy hamëndjeve, ndoshta merr pak nga të dyja. Veçse, për të qenë objektivë në përceptimin e së vërtetës mbi mënyrën dhe stilin e dialektikës politike në Shqipërinë e pavarur, duke u nisur nga marrëdhëniet ndërmjet protagonistëve e opinionet e shprehura për njëri tjetrin, provohet një hidhësi në gojë e një trishtim në shpirt. Asnjë personazh i asaj jete politike nuk mbetet pa u përbaltur, rreptësia e gjykimit kalon çdo lloj përpjekje për të kuptuar një qëndrim apo një veprim në një çast të caktuar apo në një ndodhi të veçantë, kur ajo nuk përkonte me mendimin e analizuesit. Shumica dërmuese ishte e gatëshme të bënte vetëm procese mediatike apo historike, pa e vënë veten në rolin e atij që kritikohej. Duke përjashtuar 47-vjetëshin e diktaturës komuniste, në të cilën gjykimi nuk jepej nëpërmjet opinionëve, por plotoneve t'ekzekutimit, viteve të gjata të burgut e, në rastin më të mirë, të internimeve pa fund, e gjithë politika shqiptare është një vazhde kritikash, fyerjesh, paditjesh, përbaltimi të kundërshtarit, edhe atëherë kur çasti historik detyronte bashkimin në një mëndje e në një synim. Fatkeqësisht kjo dukuri vazhdon, edhe më shqetësuese në këta 25 vite të tranzicionit demokratik. Konceptet e *fair to play* dhe të respektit për mendimin ndryshe a, së paku të ballafaqimit të qytetëruar të argumentave të ndryshme, që patën filluar të japin sinjale të dobëta në vitet e fundit të Mbretërisë, u bënë hi e pluhur nga tirania komuniste dhe ende sot, mbas 25 vitesh, gjejnë shumë vështirësi e kundërshtime për të patur të drejtë qytetarie në Shqipërinë e shekullit 21.

Në këtë kuadër të përgjithshëm dëshpërues të historisë së politikës shqiptare, duhen inkuadruar edhe shkrimet e Fishtës, që nuk kanë kurrë në themelin e tyre interesin vetiak t'autorit, i cili nuk kishte asnjë dëshirë

19 Po aty, f. 112.

për të qënë politikan i mirëfilltë. Në lidhje me këtë pamje të karakterit e synimit të tij, po sjell një dëshmi mjaft kuptimplote të Mustafa Krugës, shkruar në një letër drejtuar Atë Paulin Margjokajt :

“E na, nacionalistat intelektualë e pa intelektualë? Ashtu si na ka përshkrue Fishta me satirat e tija krejt vënerë, n’ato Anzat e Parnasit me mbishkrimin kuptimplotë “Qeshem veç pse s’muj me kja”, marrë s’di prej cilit poet a filosof latin. I mjeri Fishtë, sa i deshpryem ka dekun! S’e harroj kurrë kur u përpiqshem në Shkodër në 1920 me i a mbushun mënden qi të hartojshim bashkë një programë partije politike. Mbasi më suell do kohë me fjalë, s’i gjet vetit rrugë tjetër veçse me më shporrë me të vërtetën e idhët qi mendonte: “Pse po lodhe, more Mustafë, më tha, Shqipnija qi duem ti e un nuk bâhet!”²⁰

Po t’i shtojmë këtij episodi, tepër domethënës, faktin e njohur se ai dhe Luigj Gurakuqi qenë kundërshtarët më të mëdhenj të ndonjë prirjeje për të krijuar partinë Demokristiane shqiptare në kohën e tyre, do të bindemi se shkrimet e tij publicistike nuk janë tjetër veçse shqyrtime ngjarjesh e personazhesh, nga këndvështrimi vetiak i intelektualit të shumanshëm e, më shumë, i atdhetarit të flaktë, në lidhje me ata probleme që ai i quante jetike e të rëndësishme për çastin e për t’ardhmen e Atdheut të tij. Në rolin e historianit e të kronistit parlamentar njëherësh, Atë Gjergj Fishta në shkrimin “Trazimet e qershorit 1924”, na jep një tablo mjaft interesante e të saktë t’atyre ngjarjeve, që çuan pastaj në t’ashtuquajturin “revolucion demokratiko – borgjez të qershorit”, me ikjen e Zogut në Jugosllavi e ardhjen e Opozitës në pushtet me kryeministrin me short, Fan S. Nolin. Në gjithë këtë paraqitje, që do t’ishte një bazë e mirë edhe për studjuesit e historisë, po shkëpus një frazë e cila na sjell mendimin e deputetit Fishta në lidhje me atentatin që u krye në hyrje të ndërtesës së parlamentit kundër Ahmet Zogut, nga ana e bashkëkrahinarit të tij, Beqir Valterit : “

“... ky atentat – të cilin në parim e dnojshin të gjithë shqyptarët e urtë e të mëçëm, tue kë në se vrasat politike posë se imorale, janë edhe shëj barbarsije të popullit kû ndodhin – bâni një pershtypje të madhe në të gjith Shqypnin, e zëmra e popullit u tëhuj edhe mâ tepër prej kryetarit të Qeveris s’vet, pse atentatin ishte tuj e mbajtë si një rezultat të politikës së tij të gabueshme e krejt personale.”²¹

Është një koncept i lëvdueshëm, të cilin historiografia komuniste asnjëherë nuk e ka pohuar, duke qënë zëdhënëse e veprës së Enver Hoxhës e komunistëve shqiptarë, të cilët vrasjet politike i kishin alfën dhe omegën e veprimtarisë së tyre kriminale, duke arritur maja të pakapëshme n’asnjë periudhë të historisë së Shqipërisë. Por nuk është i vetmi mësim që del nga

20 M. MERLIKA KRUGA - P. MARGJOKAJ, *Kuvend letrash me miqtë*, vëll. IV, Omska 1, Tiranë 2014 f. 51.

21 GJ. FISHTA, *Përndritje*, vep. cit., f. 127.

eseja e deputetit të Shkodrës, e cila nxjerr në pah edhe sjelljen e Qeverisë së Shefqet Vërlacit që nuk bëri detyrën e saj për të dënuar vrasësin e Avni Rustemit, e cila ishte dhe ajo një vrasje politike, duke dëshmuar se shumica dërmuese e politikës ishte e infektuar nga mendësia e dhunës.

“Tash qi është bënë Shqypnija, duen perbâ shqyphtarët” është një tjetër esë e gjeniut kombëtar, e shkruar më 1930, me një titull që perfrazon një shprehje të një burri shteti italian, në fundin e shekullit 19. Është një analizë e hollë dhe objektive e gjëndjes shpirtërore të kombit shqiptar, e parakushteve që do të përcaktonin ecjen e tij në jetën e pavarur. Në këtë shkrim Atë Gjergji na paraqitet në veshjen e ndërgjegjes qytetare të Kombit, një institucion moral i domosdoshëm për qënien e tij. Si një njohës i mirë i historisë së botës, n’analizën e tij filozofi e sociologu mbështetet në gjykime njerëzish të mëdhenj të popujve të tjerë, që kanë trajtuar problemin. Në prag të 20-vjetorit të themelimit të Shtetit, Fishta 60-vjeçar, nga lartësia e një përvoje të gjatë përpjekjesh e ndihmesash për çështjen shqiptare, vëren me një ndjenjë të përzjerë kënaqësie e trishtimi atë që është arritur në këta pak vite. Kujton hidhërimin e thellë, por edhe guximin e madh t’atyre pak atdhetarëve që i besuan ëndrrës Shqipëri, mes mosbesimit të shumicës dërmuese të shqiptarëve, që nuk mund t’a konceptonin jetën e tyre jashtë Perandorisë Osmane, në të cilën kishin kaluar 450 vjet.

“Mirpo, kjo liri e pamvarsí e Shqypnís, qi asokohe do t’ishite dukë një ándërr, sod po áshit një púnë e kryeme ; pse sod po ká një Shqypní pernjimend të lirë e zojë m’vedi : Shqypní me Mbret të vetin, me Qeverí e Parlament të vedin e me një ushtrí komtare..... edhë na sod presim ligjë e pare, e marrim e apim e lidhim besë e kontratë me kome tjera, si çdo tjetër shtet i lirë i ksaj bote. Kanë pasë krrokë dikurë – i ndjeftë Zoti – do zotní të mdhej atjë në Paris para Konferencës së Paqit, se s’ká Shqypní, se s’do të kishte kund Shqypní ; po, por sod ministrat e përfaqësuesit e atyne zotnive të mdhej në Tiranë, rrin tuj u kshillue shoq me shoq: jarebi, si do t’i dalim sod Naltmadhnís së Tij, Mbretit të Shqyphtarve para.... E vërtetë se sod me sod Shqypnija áshit në grat per rruga, ura e rregullime ujnash, se ktû s’ká fabrika, avulllore, udha të hekurta, etj..... Me kohë, me kujdes e me púnë të padáme Shqypnija, neper liri e pamvarsí të veten, ká me perparue – do të përparojë.”²²

Kjo tablo tregon, jo vetëm objektivitetin e lëvdueshëm të vëzhguesit e vlerësuesit të gjëndjes pa pasionin e dikurshëm të pjesëmarrësit në politikë, por edhe kënaqësinë e ligjëshme të një qytetari që ka punuar me të gjithë fuqitë e tij të shpirtit, të mendjes e të trupit, për të sendërtuar ëndrrën e “pamundur”, për të projektuar e hedhur themelet e një ngrehine, së cilës dikur pak kush i besonte. “Fillimi është gjysma e punës” thotë një proverb i yni. Fillimi qe tepër i vështirë, mes mosbesimit të gjithanshëm, intrigave dhe armiqësive të fqinjëve e përkrahësve të tyre të mëdhenj, tabuve

22 Po aty, ff. 132-133.

mendësore të shqiptarëve, një luftë botërore, interesave të kastave e të individëve, padijes së një populli, mungesës së shkollave në gjuhën shqipe etj, etj. Intelektuali largpamës, të cilin e ka shqetësuar gjithmonë e ardhmja e popullit të tij, të cilin e njuh mirë, mundohet të thellohet edhe një herë në një argument, që e ka trajtuar gjërësisht edhe më herët : a kanë filluar të vetëdijësohen kombëtarisht shqiptarët për detyrat e tyre vetiake e të përgjithëshme? Përgjigjen duhej t'a merrte nga marrëdhëniet e ndërsjellta mes qytetarëve të Shqipërisë së rilindur. Mjerisht, në këtë drejtim, dasitë krahinore, fetare e mendësore ishin ende shumë të fuqishme e pengonin krijimin e asaj bashkëqënijeje që do t'i kthente pjestarët e një populli, që flasin të njëjtën gjuhë, në një bashkësi të ngjeshur njerëzish që kanë *"tagre, detyrë e interesa të përbashkëta"* siç e huazon përkufizimin poeti kombëtar nga oratori i madh i lashtësisë romake, Ciceroni. *"Prej ktyne fjalve merret vesht, se per me këne Shqypnija shtet pernjimend i pamvarshëm edhe me u mbajtë mkâmë si shtet e me perparue, nuk asht qi shqyptari të jët shqyptár vetëm me fis – me trup ; por duhet qi të jët shqyptár me shpirt: asi shqyptari, qi të përbâjë komin e jo vetëm popullin"*²³. Kështu e sqaronte me shumë saktësi konceptin e kombit të cilin e shtjellonte në të gjithë përbërësit e tij. Duhej farkëtuar "shpirti shqiptar", duhej që "Shqiptaria" e Pashko Vasës të mos mbetej një ide abstrakte për përdorim propagandistik, por të hynte në thellësi të qënies së secilit. Për t'i a arritur kësaj, që do t'ishte themeli i qëndrueshëm i godinës shqiptare, duhej që pjestarët e bashkësisë shqipfolëse të dilnin nga lëvozhga e trashëgimisë historike të dëmshme, që i ka mbajtur të veçuar nga njëri tjetri ; duhej që ata të kuptonin se ndryshimet në besimet fetare nuk duhej të përbënin një ledh që t'i mbante të ndarë, por një larmi, e cila kthehet në një vlerë të shtuar në funksion të bashkësisë së idealeve dhe interesave ; duhej të kuptonin se dëmet apo dobitë që kishin patur në të shkuarën e gjatë perandorake, si pasojë e atyre besimeve, tashmë i përkisnin së kaluarës së pakthyeshme, se tani e tutje nuk do të quheshin më "turq" e "halldupë", por qytetarë të barabartë të Shqipërisë arbërore; duhej të zgjeronin rrezën e shikimit përtej atij realiteti të ngushtë, në të cilin kishin jetuar deri njëzet vjet më parë. Kur të vërejnë e të binden shqiptarët se tashmë kanë një Atdhe të tyre, një Shtet që do të kujdeset për të gjithë njësoj, që do t'i japë mundësi secilit të bëjë jetën e tij simbas aftësive e përkushtimit vetiak, ata do të fillojnë të interesohen për mbarëvajtjen e atij Shteti, që do të jetë edhe begatia e tyre, atëherë do të fillojnë t'a duan atë e të ndjehen pjesë e tij. Për të korrur frutet e kësaj peme, të mbjellë vetëm njëzet vjet më parë, duhet një punë e madhe e një kohë e gjatë, një politikë e ndritur nga ana e klasës politike, për të ulur skajshmërisht dallimet mes njerëzvet, të çdo forme qofshin, fetare, krahinore, pasurore, për të nxitur shfaqjen e meritave dhe aftësive vetiake,

23 Po aty, f. 134.

që shkojnë në dobi të shoqërisë, duhet një shkollë e një klasë intelektuale, që t'a kenë si synim të parë edukimin e fëmijëve e të rinjve me idenë e atdheut të përbashkët e të dashurisë ndaj tij.

A do t'arrihet kjo domosdoshmëri e jetës kombëtare, a do të bëhen shqiptarët qytetarë të denjë e besnikë të Vendit të tyre ? Poeti kombëtar është skeptik për kohën në të cilën jeton : *“Tash, me një mentaliteti në popull tonë jo vetëm se – për me folë pergjithsisht – s'mund të ket atdhedashnie ndërgegje komtare ; por, shka asht ma zî, mëngon vetë parimi i sociabilitetit, pa të cilin as s'mund të kuptohet një shtet civil mí shekull.... Mas mendimit të shkruarit të ktij artikulli, pra sod me sod ká Shqypní, por shqyptarë të vërtetë ká pak e aspak.”*

Por megjithatë ai është i vendosur : *“na do t'i përbâjmë kta shqyptarë të vërtetë. E shî në ket punë ká me u dukë mâ s'miri fuqija e zotsija e jonë, po kje se prej një populli kaq eterogjen e të trazuem psikologjikisht, mrrîjn me përbâ një kom t'unjisuem e të zonë me mbajtë mkâmë e me bâ qi të përparojë e të lulëzojë një shtet civil...”²⁴*

Ishte sfida e shekullit për Shqipërinë, lufta për mbijetesën e saj mes kombeve të qytetëruara. Ishte një sfidë së pari për inteligjencën dhe për klasën drejtuese, por edhe për secilin qytetar të Shqipërisë. Kërkonte një zotim të përgjithshëm, një përpjekje të përbashkët të gjithë shqiptarëve të ditur, duhej që të vozitnin të gjithë në një drejtim, por klasa drejtuese, e ndarë në zogiste dhe kundër zogiste nuk bashkërendonte veprimet. Megjithatë projekti i pa shpallur zyrtarisht shkonte përpara, në sajë të intelektualëve të rinj, por edhe të atyre institucioneve shekullore atdhetare, siç ishte Kisha katolike. Në ballë të saj ishte Atë Gjergji, i cili, megjithë luhatjet që pësonte nga realiteti i zymtë, në dukje i pashpresë, nuk ishte mosbesues për t'ardhmen. Në thellësi të shpirtit ai shihte një rreze drite në tunelin e gjatë e t'errët të rrugës së Shqipërisë. Ajo dritë buronte nga besimi tek bashkatdhetarët e tij malsorë, virtuteve të të cilëve u kishte kushtuar veprën më madhështore të pendës së tij, “Lahutën e Malsisë”. Ai kthehet përsëri tek ta, tek forca e tyre e karakterit, tek virtutet e racës, që përbëjnë më shumë se një shpresë, një siguri : *“Pse atje ka burrní, fisnikí, bujarí: ka besë, ka karakter kombtar të paprishun; ka... moral të shndoshtë.”* Ky i fundit ishte themeli mbi të cilin duhej të ngrihej Shqipëria e qytetëruar, bashkëkohore, evropiane, morali i thjeshtë, i trashëguar, i pastër, ai që i ka siguruar mbijetesën në furtunat e shekujve.

Me pak penelata u mundova të jap një tablo të idesë së Atë Gjergj Fishtës për Atdheun e tij. Është një tablo shumë e cunguar, sepse publicistika e tij është shumë e gjërë e për t'a trajtuar e komentuar duhen vëllime të tëra. Ideja e tij sot mund të ballafaqohet me realitetin shqiptar të pothuaj një shekulli më vonë. Në këtë shekull Shqipëria ka kaluar tragjedinë e saj më

24 Po aty, f. 139.

të madhe, komunizmin, që ka përmbysur gjithë sistemin e vlerave të botës në të cilën jetoi e punoi gjeniu poliedrik i shqiptarëve, Atë Gjergj Fishta, së bashku me veprën e tij. Fatmirësisht, ai sistem i kaloi analeve të historisë, dhe emri i Fishtës gjeti përsëri vendin e merituar në altarin e kombit e të kulturës shqiptare, me një shkëlqim të ri, sepse koha, në shumë drejtime, vërtetoi largpamësinë e tij prej gjeniu, nxori në pah vlerat e paçmuara të veprës së tij madhore e të larmishme, lartësoi në nivelin e merituar figurën e tij të gjithanëshme të klerikut shembullor, publicistit, kritikut, dramaturgut, poetit kombëtar, sociologut, filozofit, diplomatit, mësuesit e, mbi të gjitha, të atdhetarit, të shqiptarit të madh, që mbetet për jetë një nga farët më të ndritshëm të kombit e të kulturës së tij.

Abstract

Franciscan Fr. Gjergj Fishta and his ideas and programmes for the nation-building process are the focus of author Merlika in this paper.

Born in 1871, Fr Fishta was to become not only a Franciscan but also a pillar of the future ideology of the newly created Albanian state.

His articles in journals and newspapers such as *Hylli i Dritës*, *Posta e Shqypnisë*, and *Ora e Maleve* helped consolidate the national awareness of the Albanians. His essays aimed at building Albanian sameness nationwide but also distinction from other neighbouring states in order to display the peculiarities and the uniqueness of the Albanians.

In time, however, Fr Fishta had to also deal with the creation of a new civic conscience as an absolutely necessary ingredient for any modern country and nation alike.